



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

MINISTËR SHTETI PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES



**Raporti
mbi trajtimin e ankesave dhe
sugjerimeve të sipërmarrjes
për muajin maj 2019**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA

MINISTËR SHTETI PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Të nderuar miq sipërmarrës,

Në vijim të komunikimit me ju, në rolin e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, me qëllim përditësimin tuaj mbi punën e bërë gjatë këtij muaji, lejomëni të ndaj me ju raportin e muajit maj 2019 si dhe trajtimin e ankesave në kuadër të njoftimeve periodike.

Gjatë gjithë këtij muaji është vijuar me takime dhe vizita në biznese të ndryshme, për t'u njohur më në detaje me problematika specifike që shqetësojnë sipërmarrjen dhe për të proçeduar më tej me lehtësimin e komunikimit dhe zgjidhjen e këtyre çështjeve nga institucionet përkatëse.

Në mbledhjen e radhës të Këshillit të Investimeve me fokus të veçantë në stimulimin e investimeve në vendin tonë dhe rritjen e sigurisë juridike të pronës u theksua se sfida për regjistrimin e plotë dhe përfundimtar të pronës do të kalojë përmes disa proçeseve legjislativë dhe administrative. Në këtë aspekt u konsiderua i rëndësishëm përcaktimi i prioriteteve kryesore dhe komunikimi mes aktorëve të ndryshëm në realizimin e këtyre prioriteteve brenda afateve të përcaktuara.

Në kuadër të përmirësimit të marrdhënieve dhe lidhjeve të biznesit të fasonistëve shqiptarë me kompanitë italiane që operojnë në këtë fushë u realizua një takim ndërmjet përfaqësuesve të Dhomës Kombëtare të Prodhimit të Veshjeve dhe Këpucëve, me përfaqësues të Confindustria Albania si dhe me prezencën e Atasheut ekonomik të Ambasadisës italiane. Gjithashtu u organizua një takim i mëtejshëm me të njëjtën tematikë edhe me përfaqësues të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Shqipëri-Turqi dhe me prezencën e Atasheut ekonomik të Ambasadës Turke.

Në përfundim të disa takimeve intensive ndërmjet përfaqësuesve të bizneseve të cilat merren me projektet fotovoltaike dhe përfaqësuesve të institucioneve publike të cilat administrojnë çështjet e energjisë, u dakordësua në lidhje me udhëzimin i cili përcakton

proçedurën e lehtësuar të autorizimit për lidhjen e sistemit të shpërndarjes të projekteve të vogla të rinovueshme për vetëprodhuesit e energjisë elektrike nga dielli.

Duke shpresuar në vijimin e komunikimit me ju, shpreh bindjen time të thellë se nëpërmjet bashkëpunimit ne mund të përmirësojmë klimën e të bërit biznes në vendin tonë.

Me konsideratën më të lartë,

Eduard Shalsi



Regjistri i ankesave të trajtuara

Nr.	Instucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr. 1	MM	11.07.2018	Subjekti kërkon kryerjen e pagesës për sherbimet e kryera në fushën e Emergjencave Civile.	Në proces
Nr. 2	MB	06.12.2018	Subjekti ankohet në lidhje me Urdhrin e përbashket "Për ndalimin e hedhjes ne treg të fishekzjarreve"	Në proces
Nr. 3	MFE	09.01.2019	Subjekti ankohet mbi sjelljen e nënpunësve tatimorë.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 4	Bashkia	12.01.2019	Subjekti kërkon adresim ose sugjerim te procedurave qe duhet te ndiqen përsa i përket transportit urban dhe marrdhënieve me Bashkinë.	Në proces
Nr. 5	MTM	01.02.2019	Subjekti kërkon asistencë për pajisjen me lejen mjedisore dhe përgjigje ndaj kërkesës online.	Në proces
Nr. 6	Kryeministria	22.02.2019	Mbi proceduren e prokurimit me objekt "Prishje i ish Frigoriferit ne Vlore", ankuesi shprehet se KPP nuk pranon ankesën e tyre.	Në proces
Nr. 7	MFE	13.02.2019	Subjekti kërkon likuidim të detyrimeve kontraktuale nga ATK	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 8	MBZHR	17.02.2019	Kërkesë për interpelancë	Në proces
Nr. 9	MZHBR	19.02.2019	Subjekti kërkon mbrojtjen e të drejtës së ekskluzivitetit si dhe moscenimin e sigurisë ushqimore.	Në proces
Nr. 10	MIE	22.02.2019	Subjekti ankohet për pjesmarrje në proceduren konkurruese leje kërkim-zbulimi.	Në proces
Nr. 11	Bashkia	25.02.2019	Subjekti ankohet në lidhje me mosshlyerjen e detyrimeve për projektet e financuara nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale.	Në proces
Nr. 12	Bashkia	25.02.2019	Subjekti kërkon anulim dhe rishikim vendimi nga ana e Bashkisë.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 13	MSHMS	26.02.2019	Subjekti kërkon permbushjen e urdhrët të ekzekutimit.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 14	MFE	01.03.2019	Subjekti pretendon se ka pasur veprime arbitrare nga dogana në lidhje me rivleresimin e deklaratave doganore.	Në proces
Nr. 15	MFE	06.03.2019	Subjekti ankohet për penalitet te lartë nga administrata tatimore.	Në proces
Nr. 16	Kryeministria	10.03.2019	Subjekti kërkon legalizimin e objektit ku ushtron aktivitetin bar-kafe.	Në proces

Nr.	Instucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr. 17	MFE	13.03.2019	Subjekti kërkon hapjen e një nipti sekondar nga Drejtoria Doganore.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 18	Bashkia	18.03.2019	Subjekti kërkon pagesën e detyrimeve të prapambetura nga ana e Bashkisë Durrës për punimet e kryera nga subjekti ne vitin 2014.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 19	MIE	14.03.2019	Subjekti kërkon përmirësim të rrugës për të aksesuar biznesin.	Në proces
Nr. 20	MFE	15.03.2019	Subjekti ankohet per kushte diskriminuese për lejimin e ushtrimit të profesionit arkititekt dhe inxhinier.	Në proces
Nr. 21	MFE	16.03.2019	Subjekti ankohet për vendosjen e një gjobe të padrejtë.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 22	MEPJ	18.03.2019	Subjekti ankohet ne lidhje me kriteret e perzgjedhjes për një procedure tenderi.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 23	MFE	21.03.2019	Subjekti kërkon përfshirjen e fidanëve të shafranit në listën e inputeve bujqësore të përjashtuara nga TVSH-ja.	Në proces
Nr. 24	MFE	28.03.2019	Subjekti denoncon konkurrencen e pandershme qe zhvillohet nga bizneset online te paregjistruara ne QKB qe operojne permes Instagram & Facebook.	Në proces
Nr. 25	Bashkia	29.03.2019	Subjekti kërkon asistencë për zbardhjen e Lejes së Ndërtimit të aprovuar në 2007 nga Bashkia e rrethit Elbasan.	Në proces
Nr. 26	MIE	29.03.2019	Subjekti ankohet ne lidhje me faturim te pasaktë të energjisë elektrike.	Në proces
Nr. 27	MD	01.04.2019	Subjekti kerkon informacion në lidhje me statusin e dosjes së tij nga zyra e Aluiznit.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 28	MTM	01.04.2019	Subjekti kërkon informacion se si do procedohet me Ligjin e Gjuetisë.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 29	MTM	02.04.2019	Ankese per moszbaztim te vkm nr. 115, dt 6.03.2012 dhe VKM nr. 232, dt 26.04.2012	Në proces
Nr. 30	Kryeministria	06.04.2019	Subjekti kërkon asistencë në lidhje me një leje ndertimi.	Në proces
Nr. 31	MFE	08.04.2019	Subjekti kërkon vertetimin e veprimtarisë së një shoqërie që kryen konkurrence të padrejtë në treg.	Në proces
Nr. 32	MFE	10.04.2019	Subjekti ankohet për detyrimet tatimore dhe ndaj Bashkise.	Në proces

Nr.	Instucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr. 33	MIE	11.04.2019	Subjekti ankohet në lidhje me procedurat e miratimit të një impianti fotovoltaiak.	Në proces
Nr. 34	MFE	12.03.2019	Subjekti kërkon informacion të metejshëm në lidhje me formatin e flete analizave për eksport.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 35	Bashkia	13.04.2019	Subjekti ankohet në lidhje me penalizimin për moslëshimin e kuponit të kasës.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 36	MFE	15.04.2019	Subjekti kërkon rimbursimin e TVSH-së.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 37	Bashkia	15.04.2019	Subjekti kërkon likuidimin e një fature tenderi me Bashkinë Elbasan.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 38	MTM	15.04.2019	Subjekti kërkon miratimin e procedurës dhe përditesimet përkatëse në kadastrën e pyjeve.	Në proces
Nr. 39	MBZHR	15.04.2019	Subjekti kërkon verifikimin e reklamave të pasakta, kontrollin dhe ndalimin e përdorimit nga konkurrenca e ambalazheve të shoqërisë.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 40	Bashkia	15.04.2019	Subjekti kërkon mbështetje për ngritjen e qendrës së zhytjes në Vlorë.	Në proces
Nr. 41	Bashkia	16.04.2019	Subjekti kërkon asistencë për shlyerjen e detyrimeve për procedurën e prokurimit.	Në proces
Nr. 42	MIE	17.04.2019	Subjekti ankohet në lidhje me ndërprerjet e energjisë që ndikojnë funksionalitetin e fabrikes.	Në proces
Nr. 43	Bashkia	18.04.2019	Subjekti ankohet në lidhje me mos likuidimin e faturave dhe dëmin ekonomik të shkaktuar nga Bashkia Klos për objekte tenderimi të perfunduara.	Në proces
Nr. 44	MIE	23.04.2019	Subjekti ankohet për mos-kthim përgjigje nga ana MIE	Në proces
Nr. 45	MIE	22.04.2019	Subjekti ankohet në lidhje me një problematike nga OSHEE për shtim fuqie të energjisë elektrike.	Në proces
Nr. 46	Bashkia	23.04.2019	Subjekti kërkon verifikim dhe ndryshim të taksave vendore të pasakta të vendosura në lidhje me një pronë.	Në proces
Nr. 47	MFE	24.04.2019	Subjekti kërkon një ndihmë për përdorimin e një ambalazhi ku është printuar gabimisht datë skadence.	Trajtuar me zgjidhje

Nr.	Instucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr. 48	MFE	24.04.2019	Subjekti kërkon financim për ndryshim të teknologjisë së subjektit.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 49	MFE	24.04.2019	Subjekti kërkon rimbursimin e TVSH-së kreditore.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 50	Bashkia	22.04.2019	Subjekti ankohet për mos-zbatim të një vendimi gjyqësor.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 51	MFE	25.04.2019	Subjekti ankohet në lidhje me mbartjen e detyrimit doganor për makineritë agrobiznes të importuara nga Gjermania, për të cilat është vendosur kod doganor pa e patur këtë.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 52	MFE	26.04.2019	Subjekti kërkon asistencë për përfitimin e një granti për realizimin e biznesit të tij.	Në proces
Nr. 53	MFE	26.04.2019	Subjekti ankohet në lidhje me një kontroll tatimor ndaj subjektit të cregjistruar.	Në proces
Nr. 54	MD	27.04.2019	Subjekti ankohet në lidhje me pamundësinë e legalizimit të një kapanoni në Durres.	Në proces
Nr. 55	Bashkia	30.04.2019	Subjekti ankohet në lidhje me moslargimin e një barake të shkatërruar nga bashkia.	Në proces
Nr. 56	Bashkia	30.04.2019	Subjekti ankohet në lidhje me një gjobë vendosur kundrejt një NIPT-i pasiv, administratori i të cilit ka vdekur.	Në proces
Nr. 57	Bashkia	02.05.2019	Subjekti kërkon asistencë për zhbllokimin e rruges për të aktiviteti i biznesit të tij.	Në proces
Nr. 58	MIE	01.05.2019	Subjekti kërkon pajisjen me leje të përdorimit të ujit për HEC-e ekzistuese e të ndërtuara nga shteti shqiptar por që i janë dhënë shoqërisë koncesionare.	Në proces
Nr. 59	MFE	02.05.2019	Subjekti ankohet për vendim të pa drejtë nga ana e Inspektoriatit të Punës.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 60	MFE	09.05.2019	Subjekti kërkon të cregjistrohet nga Regjistri Tregtar.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 61	MFE	08.05.2019	Subjekti kërkon informacion në lidhje me rimbursimin e akcizës drejt Drejtorisë Rajonale Tatimore Tirane, për të cilën nuk ka marrë përgjigje.	Në proces
Nr. 62	MTM	13.05.2019	Subjekti ankohet për pezullim aktiviteti.	Në proces
Nr. 63	MB	17.05.2019	Subjekti kërkon lëshimin e licencave të eksportit dhe interpretimin juridik të urdhrin 661.	Në proces

Nr.	Instucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr. 64	MBZHR	17.05.2019	Subjekti kërkon përgjigje në lidhje me aplikimin e kontrollit për jetëgjatësinë nga ana e AKU.	Në proces
Nr. 65	MFE	22.05.2019	Subjekti kërkon revokimin e Urdhërit të Bllokimit të Llogarive Bankare.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 66	MZHBR	22.05.2019	Subjekti kërkon përgjigje nga AKU në lidhje me gjobat dhe bllokimin e mallit nga ana e AKU.	Në proces
Nr. 67	MFE	22.05.2019	Subjekti kërkon zhbllokimin e llogarive personale që i janë bllokuar si pasojë e pozicionit si administrator në një biznes.	Në proces
Nr. 68	MFE	24.05.2019	Subjekti kërkon asistencë për adresimin e faturave për zhvillimin e sistemit të të dhënave akomoduese turistike.	Në proces
Nr. 69	MIE	24.05.2019	Subjekti kërkon një interpretim në lidhje me zbatimin e nenit 22 të Ligjit nr. 7/2017 'Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme'.	Në proces
Nr. 70	MIE	24.05.2019	Subjekti kërkon pajisjen me leje të përdorimit të ujit për HEC-e ekzistuese e të ndërtuara nga shteti shqiptar por që janë dhënë shoqërisë koncesionare.	Në proces
Nr. 71	MD	27.05.2019	Subjekti kërkon asistencë për rihapjen e aktivitetit	Në proces
Nr. 72	MFE	29.05.2019	Subjekti kërkon asistencë për mbylljen e aktivitetit.	Në proces
Nr. 73	MSHMS	31.05.2019	Subjekti kërkon rishikim të procedurave për publikimin e librave shkollore.	Në proces
Nr. 74	Kryeministria	08.05.2019	Subjekti kërkon lejimin e ushtrimit të aktivitetit të ndërtimit të jahteve në zonat e konsideruara "brigje".	Në proces
Nr. 75	MFE	21.05.2019	Subjekti ankohet në lidhje me situatën pothuajse monopol në treg në lidhje me shoqëritë inspektuese të ashensoreve.	Në proces
Nr. 76	MFE	01.04.2019	Subjekti kërkon kompensimin e tatimit fitimit të thjeshtuar me tatim fitimin.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 77	AMF	14.05.2019	Subjekti ankohet në lidhje me falimentimin e shoqërisë dhe problematikat e shkaktuara të grupi respektiv.	Në proces
Nr. 78	MFE	17.05.2019	Subjekti kërkon mos-aplikimin e referencës doganore.	Në proces